



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK / DMP
Nr. I rru Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. B: Prot. Prot No	03-2852/12
Date Datum Dat	10.08.2012



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËVAJTJE NË PRIZREN / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU / MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr. 12794/2011

Gjykata Komunale per Kundervajtje ne Prizren, me gjyqtarin Luan Berisha dhe procesmbajtesen Naxhis Sharani ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurit Adem Bytyqi nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes nga neni 16 al.1.1, 1.2 te Ligjit nr.03/L-151, per deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave te zyrtare te larte publike, e ne baze te nenit 195 te Ligjit mbi kundervajtjet me dt. 26.07.2012, mori

AKTVENDIM

I pandehuri Adem Bytyqi, nga i ati Jashar, i lindur me 1963 ne Prizren, ku edhe jeton ne rrugen Rozafa 2 kula 3/602, anesteziolog, ka te kryer fakultetin, i martuar baba i dy femive, me kombesi shqiptar, i pa denuar per kundervajtje.

ESHTE FAJTOR

Sepse ne cilesin e drejtorit te Departamentit per emergjence dhe reanimacion prane Spitalit te Prizrenit, ka qene I obliguar qe te beje deklarimin e pasurise, ne pajtim me nenin 6 dhe 7 te ligjit nr.03/L-151, dhe si zyrtare I larte publike nuk e ka permbushur kete obligim ligjor mbrenda afatit,

- me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 16 al.1.1, 1.2 te Ligjit nr.03/L-151, per deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave te zyrtare te larte publike, prandaj me aplikimin e nenit 10 te Ligjit mbi kundervajtjet I shqiptohet masa edukative

QORTIM

Arsyetim

Me kerkesen e Agjencionit kunder korupcionit ne Prishtine, nr. 01-3243/11 te dates 12.07.2011 eshte zhvilluar procedura kundervajttese kunder te pandehurit Adem Bytyqi nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes nga neni 16 al.1.1, 1.2 te Ligjit nr.03/L-151, per deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave te zyrtare te larte publike.

Gjendja faktike e pershkruar ne dispozitiv te aktvendimit eshte vertetuar ne baze te deklarates se te pandehurit i cili ne proqesverbalin me daten 12.03.2012, deklararon qe ne momentin kur eshte kerkuar deklarimi I pasurise ne cilesin e kryeshefit emergjences, si zyrtare I larte publike, ka qene ne specijalizim ne Turqi. Nga specijalizimi eshte kthyer ne muajin shtator dhe ka mare shfrytezimin e pushimit vjetor deri me daten 05.tetor 2011. Kur ka filluar te punoj, eshte njoftuar per obligimin e deklarimit e pasurise, andaj me te kuptuar kete obligim, I pandehuri e ka deklaruar pasurine e tije prane agjencionit antikorupcion me daten 11.10.2011, per qka si prove gjykates I parashtron vertetimin te leshuar nga parashtruesi I kerkeses Agjencija kunder korupcionit, me numer 03/3930/11 te leshuar me daten 11.10.2011, si dhe shiqimit te provave tjera ne shkresat e lendes.

03-2852/12/02
sluq

Gjate caktimit te llojit dhe lartesis se sanksionit gjykatesi ka vleresuar deklaraten e te pandehurit si dhe provat tjera te cilat gjenden ne shkresat e lendes, si rethan lehtesuese ka marur parasyshe sjedhjen tejet korekte te te pandehurit gjate dhenjes se deklarates, se I njeiti per shkak te specijalizimit ne Turqi, nuk ka qene I njoftuar ne kohen kur eshte kerkuar deklarimi I pasurise ne cilesin e zyrtarit te larte dhe ate drejtorit te Departamentit per emergjence dhe reanimacion, prane spitalit te Prizrenit "Daut Mustafa", dhe I njeiti pas kthimit nga specijalizimi, dhe shfrytezimit te pushimit vjetor gjer me daten 05.tetor 2011 me fillimin e punes, dhe pasi qe eshte njoftuar per obligimin qe ka ne cilesin e kryeshefit, menjehere pra me daten 11.10.2011, ka deklaruar pasurine prane Agjencionit antikorupcion, per qka posedon edhe vertetimin te leshuar nga parashtruesi I kerkeses me numer 03/3930/11 te dates 11.10.2011, me qka provohet qe I njeiti ka deklaruar pasurine prane organit kompetence, por kete e ka bere me vonese per shkaqet e cekura me larte, andaj me aplikimin e nenit 10 te Ligjit mbi kundervajtjet kunder te pandehurit eshte shqiptuar masa edukative qortim me bindje se edhe me kete lloje te sanksionit do te arihet qellimi i ndeshkimit.

Shpenzimet e procedures jane caktuar ne baze te nenit 109 al.2 te Ligjit mbi kundrvajtje.

Nga se u tha me larte u vendos sikur ne dispozitiv te ketij aktvendimit.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN,
Nr. 12794/2011. te dt. 26.07.2012

Procesmbajtesi
Naxhis Sharani

Gjyhtar
Luan Berisha

UDHEZIMI JURIDIK; Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh nga dorezimi munde te ushtrohet ankesa Gjykates e Larte per Kundervajtje ne Prishtine. Ankesa dergohet nepermjet te ketij gjyqit pa taksa.

